



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5545 Prot.

Vau Dejës më, 17. 10.2022

Lënda: Kërkesë për pajisje me Akt Përputhshmërie në kuadër të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau Dejës

ZNJ. ADELINA GRECA
AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
Rruga: "Muhamet Gjollesha", Nr.57, Tiranë

Bashkia Vau Dejës ka të miratuar dhe ka në fuqi aktualisht Planin e Përgjithshëm Vendor me vendimin Nr. 3, datë 27.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Pas miratimit të këtij Plani Bashkia Vau Dejës ka monitoruar zbatimin e tij në vazhdimësi dhe ka ndërmarrë nismën për rishikimin e tij për disa arsye të cilat janë trajtuar në dokumentin e nismës së rishikimit të PPV-së.

Në zbatim të nenit 23, pika 14 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 1.7.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", nenit 13, pika 1, shkronja "b", neneve 23, 24, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014, "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, neneve 10, 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit*", e ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 22.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "*Për hartimin, bashkrëndimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të përgjithshme vendore me procedure të thjeshtuar*", Bashkia Vau Dejës ka kryer procesin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për territorin e saj administrativ.

Në vijim, bazuar në nenin 9, pika 2, nenin 13, pika 1, shkronja "d", nenet 23 dhe 25 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014, "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, Nenit 2, pika 2, neneve 5, 6 dhe 8, nenit 60, pika 3, shkronja "a", nenit 62, pika 2, shkronjat "a", "b" dhe "c" të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit*", e ndryshuar, kërkojmë nga AKPT lëshimin e Aktit të Përputhshinërisë për dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vau Dejës

Duke ju falenderuar paraprakisht

KRYETARI
MARK BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHER
ZV/ KRYETARI
KRISTIAN SHKRELI

